



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT

Manual Ankesash/Kërkesash në IKMT

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka si objekt pune mbrojtjen e territorit kombëtar nga ndërtimet e kundërligjshme, zonave të mbrojtura, mjedisit dhe ujrave. Në mënyrë që puna e IKMT të përparojë, është shumë e rëndësishme dhe bashkëpunimi i saj me qytetarët, subjektet dhe median. Ankesat/ kërkesat janë zëri i qytetarëve/subjekteve, në paraqitjen e problematikave dhe zgjidhjen e tyre nga ana e institucionit. Hapat e përpilimit të ankesave/kërkesave vijnë si më poshtë:

Hapi Nr.1. Mënyrat e ankimit pranë IKMT:

- Nëpërmjet portalit e-Albania. Qytetari me llogarinë e tij në e-Albania hynë dhe kërkon në lupë Kërkesë/ Ankesë pranë IKMT.

Faqja e ankesë/kërkesës do të shfaqet me hapësirat e saj ku do të zgjidhet tipologjia e ankesës në ankesë dhe kërkesë. Nëse zgjidhet tipologjia “ANKESËS” hapësirat për tu plotësuar nga qytetari vijnë:

- Përshkrimi i problematikës me detajet e problematikës;
- Seksioni i ngarkimit të fotove të ndërtimit në proces;
- Seksioni i dokumentave plotësues/certifikatës së pronësisë;
- Seksioni për ngarkimin e kopjes së ankesës drejtuar IMT së bashkive respektive;
- Dërgo.

Nëse zgjidhet tipologjia e “KËRKESËS” hapësirat për tu plotësuar nga qytetari vijojne:

- Përshkrimi i problematikës;
- Seksioni i dokumenteve shoqëruese dhe Vërtetim për prishje objekti;
- Dërgo.
- Mënyra e dytë në drejtimin e ankesave dhe kërkesave pranë IKMT është Posta Shqipëtare. Qytetari/subjekti përpilon në mënyrë shkresore, letër, ankesën/ kërkesën që kërkon t'ia drejtoj IKMT-së, orientimi që i jepet qytetarit/subjektit apo medias është që qytetari të jetë konciz në narracionin e problematikës, pra mos shpërndahet në detaje të cilat e largojnë nga tematika për të cilën ankohet. Të bashkëlidh kopje të certifikatës së pronësisë, kopje të dokumentacioneve shoqërues, kopje të korrespondencave me IMT apo institucione të tjera, dhe foto të ndërtimit në proces. Nuk duhet të neglizhohen të dhënat e ankuesit dhe subjektit për të cilin ankohet. Në fund në zarfë të shënohet adresa e dërguesit e saktë, që të shmanget rikthimi i postës sërishtë në institucion dhe numri i kontaktit.

Hapi Nr.2 Afatet e kthimit të informacionit:

- Afatet e kthimit të informacionit janë të parashikuara në Ligjin Nr.119/2014 për të Drejtën e Informimit Neni 15 ku afati për kthimin e përgjigjes kthehet jo më vonë se dhjetë (10) ditë dhe kur korrespondenca është ndërinstytucionale afati i kthimit të përgjigjes është pesëmbëdhjetë (15) ditë. Këto afate vlejnë për ankesat e ardhura nëpërmjet postës dhe 10-13 ditë afat ligjor për ngarkimin e informacionit në portalin e-Albania.

Hapi Nr. 3 Trajtimi i ankesave dhe kanali i kthimit të informacionit:

- Trajtimi i ankesave pranë IKMT kryhet vetëm në formatin shkresor. Shumë qytetar apo subjekte nuk janë të informuar se ankesat trajtohen zyrtarisht nëpërmjet formës shkresore dhe jo nëpërmjet telefonatave apo diskutimit verbal në institucion. Ankesat e ardhura me anë të postës do të kthehen po në këtë formë në adresën e shënuar nga qytetari/subjekti në formë shkresore me vulë të njomë. Ankesat e drejtuara nëpërmjet portalit e-Albania pasi trajtohen, kthehen po në portal me

nënshkrim elektronik. Trajtimi i tyre bëhet nga drejtoritë përkatëse sipas problematikës ose i delegohen institucionit që e ka në objektin e tij të punës trajtimin e kësaj problematike.

Hapi Nr. 4 Zgjidhja e problematikave:

- Ankesat që të kenë zgjidhje të problematikës duhet të pasqyrohen qartë dhe me detaje të cilat nuk e largojnë objektin e ankesës nga shprehja faktike dhe objektive e saj. Zgjidhja e problematikës kërkon gjithashtu që qytetari/subjekti të ketë dokumenta të cilat mbështesin pretendimet e tij duke ndikuar në trajtimin me efektivitet të situatës dhe zgjidhjes së saj. Kthimi i informacionit në adresën e subjektit apo qytetarit dhe stopimi i procesit të ankimit pranë institucionit nënkupton që problematika është zgjidhur. Informacioni i përcjellë nga IKMT ka qënë informacion shterues.

Hapi Nr. 5 Arshivimi i ankesës:

- Ankesat të cilat nuk ankimohen pas përgjigjes së fundit të nisur nga IKMT, arshivohen. Gjithashtu ankesat e ezauruara nga ana e IKMT arshivohen. Nëse qytetari pas disa kohësh ngre sërish të njëjtën problematikë ajo do të trajtohet nga ana IKMT si në rastet paraardhëse.

Hapi Nr. 6 Njoftim Fillim Punimesh

- Subjektet ndërtues mund të ngarkojnë në këtë seksion të ri në portalin e-Albania, kërkesën për Njoftimin e Fillimit të Punimeve të shoqëruar me dokumentacionin tekniko-ligjor.
- Faqja e “Njoftimit të Fillimit të Punimeve” do të shfaqet me hapësirat e saj për tu plotësuar nga subjekti si vijonë:
 - Përshkrimi i problematikës me detajet e problematikës;
 - Seksioni i dokumentave tekniko-ligjor/ lejeve, projekteve, studimeve etj;
 - Dërgo.

IKMT ofron gjithashtu këto shërbime:

- Aplikim për faturë për arkëtim për subjektet kundravajtës të dënuar me gjobë;
- Aplikim për vërtetim penaliteti për subjektet kundravajtës ose jo në fushën e ndërtimit, rezervave ujore dhe produkteve të ndërtimit;
- Aplikim për vërtetim për vitet e punës të ish-punonjësve të inuk/ikmt për periudhën 2008 e në vazhdim;
- Aplikim për plotësim dhe dhënie dokumentacioni për efekt pensioni të parakohshëm, pleqërie ose invaliditeti për periudhën 2008 e në vazhdim.